



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË  
MBETJEVE

**Drejtuar:** Zj. Dorina Ndreka  
Avokate  
Klinika e Ligjit, Durrës

**Lënda:** Kthim – Përgjigje referuar suajës, Nr Prot AKUM 3606, Datë 27.11.2019

*Tiranë më, 04 Dhjetor 2019*

***E nderuar Zj. Ndreka,***

Referuar kërkesës suaj pranë Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM) “Kërkesë për Informacion” më datë 25.11.2019 në lidhje me zhvillimin dhe projektin e rehabilitimit të venddepozimit Porto Romano Durrës ju detajojmë informacionin si më poshtë:

- Situata emergjente mjedisore dhe sociale që paraqet prej disa vitesh zona e Porto-Romanos, Bashkia Durrës, angazhoi një sërë strukturash të qeverisë qendrore që merren drejtpërdrejtë dhe në datën 29.10.2018, në Bashkinë Durrës, u zhvillua Mbledhja e dytë e Komitetit të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve. Takimi konsistoi në diskutime mbi shpalljen ose jo të emergjencës për Vendgrumbullimet e Bashkisë Durrës. Komiteti vendosi mos shpalljen e emergjencës civile, por investimin në këtë zonë nga ana e qeverisë qendrore për kushtet normale higjeno-sanitare;
- Vendimi i Këshillit Teknik të Agjencisë Kombëtare të Ujësjiellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së mbetjeve (AKUM) mbledhur më datë 31.01.2019 la detyra dhe rekomandime, që projekti i paraqitur për rehabilitimin e vend depozitimit të Porto Romanos, të plotësohej dhe të realizonte qëllimin e tij final për garantimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm, në përputhje me standardet e kërkuara, kuadrin ligjor për menaxhimin e integruar të mbetjeve në R.SH. dhe direktivat e BE-së për investimet në infrastrukturën e mbetjeve;
- Këshilli Teknik, AKUM, u mblodh sërish më datë 20.06.2019 dhe shqyrtoi projektin e plotë të paraqitur nga projektuesi “Mbyllja e vend depozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta dhe ndërtimi i Eco-Park Durrës”, duke dalë me vendim Nr. 1825 Prot., datë 20.06.2019, miratimin në parim të projektit, pas vlerësimit të anëtarëve të këtij Këshilli se projekti kishte adresuar në mënyrën e duhur zgjidhjen e problematikës së rëndë mjedisore për zonën referuar rekomandimeve të lëna nga ky Këshill;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË

AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË  
MBETJEVE

- AKUM, iu drejtua zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për mbështetje dhe rialokim fondi, bazuar në projektin e miratuar nga Këshilli Teknik, AKUM, me argumentimin e nevojës për investime, fond i cili u aprovua nga MIE në Shtator 2019;

**Justifikimi i nevojës për investime në këtë rajon, nga AKUM për MIE, bazuar në gjendjen e degraduar mjedisore që zona e Porto-Romanos, Bashkia Durrës paraqet**

Trajtimi i mbetjeve urbane në qytetet kryesore dhe ato dytësore në Shqipëri kanë marrë një përshkallëzim me ritme të shpejta dhe shumë negativ, dhe në këtë panoramë jashtë çdo standardi dhe kushteve teknike që kërkon kuadri ligjor i Republikës së Shqipërisë, përfshihet edhe fusha/zona ekzistuese e mbetjeve të ngurta urbane të qytetit të Durrësit, e pozicionuar në Porto Romano. Kjo zonë depozitimi mbetjesh në situatën aktuale që është ka degraduar prej vitesh, dhe paraqet rrezik real për shëndetin e njerëzve, ndotjen e tokës, si dhe ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

Studimi i paraqitur pranë Këshillit Teknik të AKUM, dhe i miratuar nga ky i fundit më Qershor 2019, jep zgjidhje për përmirësimin e dëmeve ekstreme të shkaktuara nga trajtimi jashtë çdo kushti teknik dhe propozon trajtimin e mëtejshëm të mbetjeve në standardet e kërkuara dhe direktivat e BE-së, për mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjes. Ky projekt ka për qëllim parësor përcaktimin e masave me karakter teknik dhe shkencor, për rehabilitimin e venddepozitimit ekzistues të mbetjeve të ngurta urbane të qytetit të Durrësit, Porto Romano. Projekti është një plan veprimi për t'i hapur rrugën Bashkisë Durrës, për të ecur drejt përmbushjes së detyrimeve që Shqipëria ka në menaxhimin e integruar të mbetjeve në përputhje me rekomandimet dhe standardet e BE-së. Kjo alternativë, është propozuar si zgjidhje definitive e gangrenës mjedisore që paraqet situata aktuale në fushën ekzistuese të mbetjeve të ngurta urbane të qytetit të Durrësit, në Porto Romano. Investimi për këtë projekt do t'i japë zgjidhje definitive përmirësimit dhe rehabilitimit të zonës nga tëdëmet e rënda shkaktuar zonës prej trajtimit jashtë kushteve teknike të mbetjeve urbane ekzistuese në vend depozitim, duke propozuar trajtimin e mëtejshëm të këtyre mbetjeve konform standardeve bashkëkohore dhe kushteve teknike që parashikohen në kuadrin ligjor, për ruajtjen e mjedisit nga ndotja dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve. Gjithashtu ndërtimi i Eco-Park, unik në llojin e vet, do të rivitalizojë zonën dhe do t'i ofrojë qytetarëve të Durrësit një hapësirë unike rekreative.

**Statusi aktual i procedurës**

Aktualisht AKUM ka përfunduar procedurat e prokurimit dhe është hedhur në sistemin e APP në datë 17 Tetor 2019, dhe në rast se nuk do të ketë ankimime nga subjektet pjesëmarrëse si për Kontraktimin ashtu edhe për Supervizimin pranë KPP, dhe procedurat vijojnë konform afateve ligjore nga institucionet e përfshira në proces, si ato qendrore (AKUM dhe Ministritë e Linjës), AKUM ka aplikuar në Nëntor 2019 pranë Këshillit Kombëtar Territorial - KKT (për lejen e ndërtimit dhe zhvillimit të zonës) dhe ka marrë paralelisht masat me njësinë vendore (Bashkia Durrës) parashikohet që nisja e investimit të startojë zyrtarisht brenda Dhjetor 2019, nëse situata e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË  
MBETJEVE**

Emergjencës Civile shpallur nga Qeveria Shqiptare për Qarqet Tiranë e Durrës nuk do të sjellë vonesat respektive.

Nëse procedurat do të kenë ankimime apo vonesa nga institucionet që përfshihen në këtë proces parashikohet nisja e investimit brenda Janar-Mars 2020.

Projekti 3 vjeçar për nga kompleksiteti i tij jo vetëm do të garantojë kapsulimin dhe rehabilitimin e venddepozitimit aktual në Porto Romano, por edhe do të shndërrojë zonën në një park unik i vetmi në Ballkan duke realizuar ndërtimin e ECOPARK Durrës zonë rekreative , sportive për çdo moshë.

Në kuadër të detyrimeve që rrjedhin nga Kushtetuta si dhe nga procesi i asocilmit në BE, Shqipëria ka miratuar Strategjinë dhe Planin Kombëtar për MIM. “Synimi i Strategjisë është që ti shërbejë sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe plotësimit të kushteve të Shqipërisë për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (BE), vazhdimin e përforsimit të institucioneve ekonomike dhe sigurisë rajonale, si dhe bashkëpunimin Euro-Atlantik në fushat e sigurisë dhe të ekonomisë.”

Sektori i Menaxhimit të integruar të mbetjeve (MIM) ndikohet në mënyrë të veçantë nga ligjet 139/2015 “Për vetë – qeverisjen vendore”, sikundërse edhe Ligji 119/2014 “Për ndarjen administrative dhe territoriale të njërive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri”, të cilët kanë reformuar tërësisht sistemin e pushtetit vendor në Shqipëri. Ndërsa Ligji 119/2014 e zvogëloi numrin e Njërive të Qeverisjes Vendore (NJQV) nga 373 njësi në vetëm 61 bashki, Ligji 139/2015 ka ritheksuar autoritetin e plotë dhe të zgjeruar të pushtetit vendor mbi MIM, duke përcaktuar se:

- Grumbullimi, transporti, depozitimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta bashkiake janë një funksion i bashkive (neni 23, pika 10);
- Bashkitë mund të përdorin cdo instrument, i cili i lejon ato të sigurojnë një menaxhim të qëndrueshëm i tillë që kombinon cilësinë, sasinë dhe koston e përballueshme prej tyre (neni 32, pika 1);
- Vendosijen e tarifës për të mbuluar kostot e shërbimit (neni 9, pika C/b);
- Vendosijen e standardit në nivel të njëjtë ose më të lartë se sa niveli kombëtar (neni 22, pikat 2 dhe 3), ndërsa qeveria duhet ti subvencionojë ato kur standardi kombëtar është i papërballueshëm nga ana financiare prej bashkive.

Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është e angazhuar maksimalisht në garantimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për qytetarët shqiptarë, në përputhje me angazhimet që ka marrë qeveria shqiptare në sektorin e mbetjeve, duke u udhëhequr nga dokumentat strategjike të sektorit sic është MasterPlani Kombëtar i Mbetjeve të ngurta (draft, 2019).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS  
DHE ENERGJISË**

**AGJENCIA KOMBËTARE E UJËSJELLËS KANALIZIMEVE DHE INFRASTRUKTURËS SË  
MBETJEVE**

Vitet e fundit siç edhe këto dokumenta strategjike sugjerojnë, ka pasur përparime të konsiderueshme në Shqipëri lidhur me hartimin e kuadrit rregullator në përputhje me politikat e Bashkimit Europian (BE) në sektorin e menaxhimit të mbetjeve, por nga ana tjetër zbatimi në nivel rajonal apo vendor dhe arritja e objektivave të rëna dakord ka mbetur ende prapa.

Për këtë qeveria shqiptare ngelet e angazhuar maksimalisht për të mbështetur qeverinë lokale, në përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Duke shpresuar t'ju kemi dhënë sqarimin e nevojshëm referuar kërkesës suaj, ju falenderojmë për interesimin dhe bashkëpunimin.